

## **AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES**

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetorë, 2001 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi Autoritetin Bankar dhe t Pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 52, 53 dhe 54 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

### **Rregulli 24 mbi Qeverisjen e Përbashkët të Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit**

#### **Neni 1**

##### **1. Shtrirja e Rregullit**

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuar nga BPK-ja

##### **2. Autoriteti Ligjor**

Ky rregull implementon nenin 52, nenin 53, dhe nenin 54 të kapitullit VIII të rregullores së sigurimeve.

##### **3. Definicionet**

Në këtë rregull, termet që vijojn kanë këtë kuptim:

“Bordi i Drejtorëve” nënkupton nivelin me të lartë të trupit qeverisës të një korporate të përbërë nga anëtarët e zgjedhur me të drejtë vote. Në këtë rregull, termi “bordi i drejtorëve” I referohet :

- a) Ne raste të korporates apo kompanise të themeluar dhe që ekziston nën ligjet e Kosovës, bordi I drejtorëve e organizon veten.
- b) Ne raste të kompanise të inkuorporuar në një juridksion tjetër, por që është I licensuar për të bërë biznesin e sigurimeve në Kosovë, zyrtari I lartë I kompanise në Kosovë, I cili është banor i Kosovës dhe I pranuar si I till nga BPK-ja.

“Bordi” i referohet bordit të drejtorëve siq është definuar në këtë rregull.

“Kompania e licensuar” i referohet të dyjave, kompanise së sigurimit dhe ndermjetesuesit të sigurimit.

“Zyrtari i lartë” është zyrtari i nivelit më të lartë, të një kompanie të sigurimit, duke e përdorur titullin e “Kryetarit” apo “Nënkryetarit”, “Drejtorit Menaxhues”, “Përfaqësuesit të Shtetit”, “Menaxher” apo ndonjë titull tjetër i tillë.

“Perfitimet” nënkuptojnë totalin e të gjitha pagave, shumave të zbritura, ditoret, dhe benefitet e tjera të pranuar, në kesh në mënyrë tejtër, nga një person që përfshihet vlerën e opsioneve rezervë, pensioneve, dhe kompenzimeve të tjera të nënshtruara, të bëra për benefitin përkatës të atij personi.

“Transaksionet pa interes” nënkupton hyrjen e dy (apo më shumë) personave, pa bindje dhe forcë por në mënyrë vullnetare, me kuptim të plotë të natyrës së transaksionit, duke u bazuar në njohurin dhe konsideratën që vlera e ndërruar të jetë e barabartë aty.

“Dekorimi” nënkupton zmadhimin me vetdëshirë të kushteve financiare të kompanisë apo rezultatit të operimit duke përfshirë, por duke mos e kufizuar, në mosraportimin e humbjeve, përmbajtjen apo vonimin e miratimit të dëmit të raportuar apo zvoglimin e qëllimshëm të dispozitave teknike.

## **Neni 2**

### **Roli dhe Përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve**

#### **1. Roli i Bordit të Drejtorëve**

- a) Qeverisja e përgjithshme e kompanisë. Determinimi dhe themelimi i politikës udhëheqëse administrative dhe operative të një kompanie të licensuar mbështetet në bordin e drejtorëve.

- b) Obligimet tutoriale (të lëna në mirëbesim). Bordi i drejtorëve i ngarkuar me përgjegjësi tutoriale për dhe në interes të aksionarëve. Ai do të çfuqizoj fuqitë e veta dhe privilegjet në atë mënyrë e cila vazhdimisht do t'i përmbushë këto obligime tutoriale.
- c) Përgjegjësia themelore. Përgjegjësia themelore për kushtet financiare dhe rezultatet operative të biznesit të një kompanie të licensuar bie mbi bordin e drejtorëve.

## **2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve**

- a) Themelimi i politikës dhe direktivave administrative. Bordi i drejtorëve duhet të kalojë, miratojë, dhe të adaptoj rezolutat të cilat përshkruajn:
  - 1. Rregullat dhe procedurat për emërimet, zgjedhje, rizgjedhje, kualifikime dhe përfitime të anëtarëve të bordit në pajtim me marrëveshjen e korporatës dhe statutit dhe sipas kërkesave të ligjeve relevante të Kosovës dhe/apo direktivave të BPK-së. Është maturi për bordin që në mënyrë të kurtë të ngarkoj një qëllim apo objektivë specifike të qeverisjes së korporatës, përgjegjësinë dhe zotimin e një anëtari.
  - 2. Rregullat dhe procedurat për planifikimin e strukturës operative të korporatës, funksioneve, koordinimit dhe balancit në mes të funksionarëve të ndryshëm në tabelën e organizatës për organizimin që përfshinë një definim të qartë të përgjegjësisë, një sistem të procesit të vendimmarrjes, dhe bashkveprim të menaxhmentit në mes tyre dhe bordit.
  - 3. Rregullat dhe procedurat e nominimit, caktimit, kualifikimit, funksionimit dhe përfitimit të zyrtarëve ekzekutiv të kompanisë, dhe shqyrtimin periodik; dhe duhet të përshkruaj direktivat e përgjithshme të zbatueshme për punëtorët e tjerë të kompanisë duke përfshirë një sistem të pagave dhe administratës dhe shqyrtimin periodik të saj.
  - 4. Instalimi i procedurave adekuate të kontrollit të menaxhmentit, për të siguruar që përgjegjësitë janë të ndara për të arritur një balanc në fuqin dhe autoritetin brenda kompanisë, kështu që asnjë individ të mos ketë fuqi absolute të vendimmarrjes.
  - 5. Rregullat që përqëndrohen në konflikt interesash, ndalimin e transaksioneve të palëve të afërta, transaksionet që nuk i përmbushin “transaksionet pa interes” dhe “dekorimet”, dhe grindjet e tjera të detyrës së tutorit dhe përshkrimin e sistemit të zbulimit të mëhershëm dhe raportimit të shpejtë të devijimit, menaxhmentit dhe bordit. Bordi duhet të

themeloj dhe organizoj një komitet të përcjelljes, të kryesuar nga një anëtarë i bordit, për të siguruar se biznesi i udhëhequr i të gjithë anëtarëve të bordit, menxhmentit dhe punëtorëve nuk i prishë obligimet tutoriale drejt aksionarëve të kompanisë.

6. Instalimi i sistemit adekuat dhe efektiv të kontrollit të brendshëm.
7. Caktimi i ekspertit të sigurimeve dhe revizorit të jashtëm, çdo njeri prej tyre duhet t'i ketë kualifikimet e përshkruara nga rregullorja e sigurimeve dhe këtyre rregullave dhe direktivave të BPK-s.
  - b) Themelimi i politikës operative dhe direktivave. Bordi i drejtorëve duhet të kaloj, miratoj, dhe të adaptoj rezolutat të cilat përshkruajn:
    1. Misioni i kompanisë me strategji të definuar të objektivave dhe arritjeve të atij misioni dhe për të përshkruar mjetet e arritjes së këtyre objektivave dhe të monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve
    2. Filozofia e investimit, politikat dhe porositë në pajtim me rregulloren e sigurimeve dhe këtyre rregullave.
    3. Themelimi i një marrje të sigurimit apo riskut të komitetit të menaxhmentit që duhet të definoj direktivat e marrjes në sigurim dhe të miratoj selektimin e riskut dhe pranimin e riskut, që të mos bjen në direktiva dhe të rekomandoj natyrën dhe shtrirjen e ruajtjes së riskut, lënien e riskut dhe pëlqimet për risigurim.
    4. Themelimi i një komiteti për dëme apo ankesa të klientëve, për t'i adresuar ankesat e aksionarëve dhe për të themeluar një mori të procedurave se si të shqyrtohen këto ankesa, të vendoset për to dhe t'i komunikohen aksionarve të brengosur dhe menaxhmentit të kompanisë.

### **Neni 3**

#### **Raportet që kërkohet të dorëzohen në BPK**

##### **1. Raportet e Verifikuara**

Me apo para ditës së 15-të të Janarit, të cdo viti, dhe në cdo kohë siç mund të kërkohet nga BPK-ja, bordi i drejtorëve i kompanisë së licensuar dhe zyrtarët e lartë të kompanisë së huaj të licensuar nga BPK-ja, duhet t'i arkivojnë dhe t'i dorëzojnë BPK-së një raport të verifikuar, të nënshkruar nga ata, duke i pohuar, në minimum, faktet që vijnë:

- a) Cdo anëtar i bordit, zyrtari i saj i lartë dhe të gjithë zyrtarët, punëtorët apo individët të lidhur me kompaninë, kërkohet nga ata që t'i përmbahen testit, "përshtatshmërisë" të përshkruar nga rregullorja e sigurimeve dhe këtyre rregullave, se vazhdimisht I kanë përmbushur kërkesat e "përshtatshmërisë" gjatë vitit të menjëhershëm të përfunduar financiar, apo gjatë një periudhe të caktuar siç mund të kërkohet nga BPK-ja dhe/apo, nëse, nuk bëhet një gjë e tillë, emrin e individit apo individëve dhe arsyen apo arsyet për mos përmbushjen e këtyre kërkesave.
- b) Niveli i besnikërisë në qeverisjen e korporatës, principet e adoptuara nga ata dhe arritjeve përkatëse të objektivave të shpallura.
- c) Se bordi vazhdimisht e mbanë pamvarësinë e vet dhe të mbeturit të lirë nga influencat e mbrendshme dhe të jashtme gjatë vitit financiar të sapa përfunduar apo, nëse ndryshe, natyrën dhe shkallën e ndërhyrjes dhe të vendimit apo rezolutes të adoptuar në lidhje me të.
- d) Qështje të tjera të kërkuara nga BPK-ja në pajtim me rregulloren e sigurimeve dhe këtyre rregullave.

## **2. Raportet e Zbulimit**

Me apo para ditës së 15-të të Janarit, të cdo viti, dhe në cdo kohë siç mund të kërkohet nga BPK-ja, bordi i drejtorëve i kompanisë së licensuar dhe zyrtarët e lartë të kompanisë së huaj të licensuar nga BPK-ja, duhet t'i arkivojnë dhe t'i dorëzojnë BPK-së një raport të zbulimit në lidhje me sa vijon:

- a) Shumën e përfitimeve të zotëruara nga cdo anëtar i bordit gjatë vitit të kaluar financiar apo gjatë një periudhe të caktuar kohore siç mund të kërkohet nga BPK-ja.
- b) Shumën e përfitimeve të autorizuar nga bordi dhe të zotëruar nga zyrtarët e lartë dhe zyrtarët e tjerë, të kompanisë për të cilët bordi përcakton pagesën e tyre, gjatë vitit të kaluar financiar të përfunduar apo gjatë një periudhe të caktuar siç mund të kërkohet nga BPK-ja.
- c) Transaksionet e palëve të afërta apo transaksionet me kompaninë e sigurimit apo ndërmjetësuesin e sigurimit.
- d) Qështje të tjera të kërkuara nga BPK-ja, për t'u zbuluar në pajtim me rregulloren e sigurimeve dhe këtyre rregullave.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

Ky rregull, do të hyjë në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman  
Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral